

Qamil Gexha

## DEMONSTRATAT ANTIFASHISTE NË GJAKOVË GJATË LËVIZJES NACIONALÇLIRIMTARE (1941—1943)

Një ndër format e Lëvizjes në Kosovë dhe Gjakovë, përveç aksioneve të ndryshme, si prerja e shtyllave telefonike, prishja e rrugeve, urave e tjera, ishin edhe demonstratat antifashiste.

Pas formimit të Komitetit lokal të PKJ të Gjakovës, Rekës dhe Podrimes, në vjeshtë të vitit 1941, u vendos që të përdoret kjo formë e rezistencës së komunistëve të Shqipërisë dhe të fillojë kështu organizimi i demonstratave për masovizimin sa më të madh të lëvizjes të shqiptarët dhe të krijojë tek ata disponim antifashist.

Forma të këtilla rezistence qenë praktikuar në Shqipëri në kohën e pushtimit fashist italian. Sipas shembullit të demonstratave në Shqipëri, të cilat u organizuan së pari nga ana e grupeve komuniste e pastaj nga ana e Partisë komuniste të Shqipërisë, edhe komunistët shqiptarë të Kosovës e shfrytëzuan këtë formë rezistence për të krijuar disponimin antifashist dhe për të masivizuar LNÇ, duke e përfshirë në të popullsinë shqiptare.<sup>1</sup>

### Demonstrata e 28 nëndorit të vitit 1941

Gjatë gjysmës së dytë të vitit 1941 u përdorën edhe mundësitë e format legale të demaskimit të pushtuesve fashistë dhe të bashkëpunorëve të tyre. U bënë përpjekje që të sabotohen ose të shndërron në demonstrata tubimet e ndryshme e madje edhe vetë manifestimet fashiste.<sup>2</sup>

Më 28 nëndor të vitit 1941 pushtuesi dhe pushteti kuisling, për të provuar se gjoja kanë ardhur për ta »shliruar« popullin shqiptar, përgatitën festën kombëtare të shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë. Në këtë drejtim ata përpiluan një program dhe ia dërguan çdo prefekturë për ta publikuar pastaj edhe në shtyp. Ata kishin për qëllim të tregonin se gjoja fashizmi nuk ishte kundër manifestimeve dhe traditave nacionale shqiptare.

<sup>1</sup> *Shënime stenografike të LNÇ të Gjakovës, f. 92.*

<sup>2</sup> *Po aty.*

Në mbledhjen e vet Komiteti lokal, para demonstratave, vlerësoi situatën politike, disponimin e masave dhe forcën e Partisë. Duke qenë se komunistët kishin ndikuar në krijimin e disponimin antifashist te masat e qytetit, Komiteti bëri mirë që mori vendim për organizimin e demonstratave, të cilat do ta thellonin edhe më tepër këtë disponim antifashist të Gjakovës.<sup>3</sup>

Në këtë mbledhje Komiteti kishte bërë të gjitha përgatitjet e duhura: kishte caktuar parullat, personat që duhej t'u flisnin pjesëmarrësve në demonstrata, vendin ku duhej mbajtur fjalimi, vendtubimin dhe rrugën nga do të shkonin, këngët që do të këndoheshin gjatë demonstratave, komunistëve e komunistëve të rinj iu caktua si detyrë që t'i grisin të gjithë flamujt e pushtuesit dhe ata shqiptarë me shenjë e lektorit për t'i zëvendësuar me flamujt e vërtetë kombëtar shqiptarë.<sup>4</sup>

Organizuesit kryesorë të demonstratave ishin: Fadil Hoxha, Emin Duraku, Xhevdet Hamza, Xheladin Hana, Mazllum Këpuska, Qamil Brovina, Hysni Zajmi etj.<sup>5</sup>

Nga parashikimi se mund të shkaktohej ndonjë konflikt me pushtuesin dhe bashkëpuntorët e tij, disa demonstrantë morën me vete dy bomba dhe tri revole.<sup>6</sup>

Në këto demonstrata morën pjesë 4000—5000 veta, numër ky mjaft i madh, kur dihet se qyteti atëherë kishte diçka më tepër se 13.000 banorë.<sup>7</sup>

Demonstruesit u tubuan në vendin e caktuar më parë, në oborrin e shkollës fillore »Bajram Curri«, së këndejmi u nisën drejt Qarshisë së vogël, ku Xheladin Hana mbajti një fjalim para masës demonstruese kundër fashizmit italian dhe bashkëpunëtorëve të tij.<sup>8</sup>

Rreshti i demonstruesve ishte aqë i madh sa nuk mbahej dot në mend. Demonstruesit nga Qarshia e Vogël shkuan në drejtim të Medresës së Vogël për në lagjen e Mulla Jusufit e prej këndej nëpër Qarshinë e Madhe e gjer te Varrezat e Qerimit. Pastaj u kthyen në drejtim të Kafenesë së Madhe. Këtu dual gjindarmëria për t'i shpërndarë, mirëpo turma shpërthei dhe vazhdoi rrugën në drejtim të Namazxhahut (pazarit të sotëm).<sup>9</sup>

Në Namazxhah Fadil Hoxha mbajti një fjalim, i cili zgjati gjysmë ore.<sup>10</sup> Ai foli për mbi vuajtjet e shqiptarëve, mbi lirinë, mbi luftën që atëherë po zhvillohej, mbi qëllimet e fashizmit, mbi frontin antifashist, mbi luftat që po bënin Bashkimi Sovjetik, partizanët e Shqipërisë, të Serbisë e të Malit të Zi, mbi luftën e aleatëve. Ishte hera e parë që një komunist fliste kështu para masës së gjërë.<sup>11</sup>

Gjatë rrugëve nga kalonin demonstruesit u kënduan këngët: »Moj Shqipni e mjera Shqipni«, »Largou sulltan se s'ke çka ban«,

<sup>3</sup> Ali Hadri, *Gjakova e Kuqe* (dorëshkrim) f. 367.

<sup>4</sup> *Po aty*, f. 369.

<sup>5</sup> Si shën. 1, f. 92-93.

<sup>6</sup> Muzeu i Gjakovës, letër e Fadil Hoxhës.

<sup>7</sup> *Po aty*.

<sup>8</sup> Si shën. 3, f. 369.

<sup>9</sup> *Po aty*.

<sup>10</sup> Si shën. 1, f. 96

<sup>11</sup> *Po aty*.

»Kuç është ku lind dhe përendon« etj.<sup>12</sup> Gjithashtu brohoritnin parullat: »Rroftë Partia komuniste«, »Rroftë armata e kuqe dhe Bashkimi Sovjetik«, »Rrofshin partizanët!«, »Poshtë okupatori!«, »Askush s'guxon të shkojë në frontin e Lindjes!«, »Poshtë flamuri i fashizmit!« etj.<sup>13</sup>

Demonstratat zgjatën tri orë dhe pasi u krye qëllimi i paraparë, demonstruesit u shpërndanë. Në mbrëmje komunistët dhe të rinjtë më aktivë i grisën flamujt e Italisë dhe ata të Shqipërisë me shenjat e lektorit që ishin varë para dyqaneve dhe shtëpive për nder të festës kombëtare. Mbetën të valojnë vetëm flamujt e vërtetë shqiptarë.<sup>14</sup>

Gjatë demonstratave pati dy raste që duhet përmendur. Disa dëshironin që demonstruesit t'i drejtonin në Rrugën e sërbëve, mirëpo këtë s'e përfillën organizatorët dhe demonstruesit; rasti i dytë ishte kur një bashkëpunor i pushtuesit, me flamurin shqiptar me shenjën e lektorit u fut në turmë, por demonstruesit ia rrëmbyen nga duart, e grisën dhe e hüdhen për tokë.<sup>15</sup>

Pushtuesi përdori ushtrinë dhe karabinierinë kundër pjesëmarrësve në demonstrata e sidomos kundër organizuesve kryesorë të tyre.

Fadil Hoxha u detyrua të largohet nga shtëpia tri ditë me radhë për shkak se policia e kërkonte. Karabinieria e burgosi Fadil Hoxhën së bashku me punëtorin Kadri Abrashi.<sup>16</sup> Në burg Fadili mbeti tetë ditë. Për mungesë materiali e lëshuan me kusht që menjëherë të shkojë mësues në fshatin Hogosht dhe se »po të shihet prapë në Gjakovë kanë për ta arrestuar«. Në këtë fshat punoi dhjetë ditë. Me urdhërin e Komitetit të vendit u kthye prapë në Gjakovë, tani ilegal. Pushteti kuisling, duke parë rrezikun nga mësuesi komunist, i shkolluar në Shqipëri, sidomos pas demonstratave të nëndorit 1941, nëpërmjet të Ministrisë së arësimit, pyeti disa herë telegrafisht nëse Fadil Hoxha, Talat Jakupi, Elhami Nimani, Sahit Bakalli etj. kanë shkuar në detyrat ku ishin caktuar si mësues, »përndryshe do të mirren masa të ndieshme kundër tyre«. <sup>17</sup> Telegrami mban datën 17. XII. 1941. Drejtori didaktik i shkollës së Gjakovës lajmëron Ministrinë e arësimit nëpërmjet të inspektoratit të arësimit se »Fadil Hoxha asht nisë me krye detyrën më 25. XII. 1941«. <sup>18</sup>

Lidhur me organizuesin tjetër të këtyre demonstratave, në dosjen e Komandës së Batalionit të IV të Karabinierisë që ia dërgon Komandës Epreore të Karabinierisë, Xheladin Hana karakterizohet si komunist, antiitalian, intuitiv, intelgjent, bashkëpunor i Fadil Hoxhës. Theksohet se është transferuar nga Gjakova në Kijevë në detyrë të mësuesit, sepse ka hequr flamurin italian dhe në vend të tij ka vënë flamurin kombëtar shqiptar. Në këtë dokument Fadil

<sup>12</sup> Si shën. 6.

<sup>13</sup> Po aty.

<sup>14</sup> Si shën. 1, f. 94.

<sup>15</sup> Si shën. 6.

<sup>16</sup> Si shën. 1, f. 93.

<sup>17</sup> Muzeu i Gjakovës, dokument i parregjistruar.

<sup>18</sup> Muzeu i Gjakovës, dokument i parregjistruar.

Hoxha karakterizohet kryetar i komunistëve, shumë i rrezikshëm. Këto shënime për Fadil Hoxhën dhe Xheladin Hanën, Beqir Maloku ia kishte dhënë Komandës së Batalionit të IV të Karabinierisë, të cilin spiunazhi italian e konsideronte si bashkëpunëtor të besueshëm.<sup>19</sup>

Demonstratat e 28 nëndorit 1941 i treguan pushtuesit dhe bashkëpunëtorëve të tij se shqiptarët e Gjakovës janë kundër tyre, se janë në anën e Lëvizjes nacionalçlirimtare dhe se demagogjia e tyre nuk kishte sjellë rezultatet e pritura. Këto demonstrata patën ndikim jo vetëm te shqiptarët e Gjakovës, por në tërë Kosovën, duke ndikuar në mënyrë pozitive në aktivizimin e Lëvizjes në Kosovë.

Dragutin Gjorgjeviqi në gazetën »4 Juli«, nr. 478 të vitit 1971, për demonstratat e 28 nëndorit 1941 shkruan se populli pranoi me dëshirë fjalët e Fadil Hoxhës dhe Xheladin Hanës, se Italia nuk është shliuese e shqiptarëve, por është pushtuese dhe se shqiptarët do të ishin me të vërtetë të shliuar kur italianët do të lëshonin Kosovën, se shqiptarëve nuk iu duhet flamuri italian e gjerman e aqë më pak flamuri shqiptar me shenjën e lektorit. Më tutje ai shkruan se me punën e pandërprerë të komunistëve, Gjakova u bë fortifikatë e rezistencës dhe frikë e tmerr për pushtuesin dhe bashkëpunëtorët e tij të cilët për këtë gjë e quanin »Gjakova e Kuqe«.

#### Demonstratat e 28 nëndorit të vitit 1942

Demonstratat u organizuan edhe më 28 nëndor të vitit 1942. Organizuese e tyre ishte gjithashtu Komiteti lokal i PKJ të Gjakovës, Rekës e Podrimës.

Organizata e Partisë së Gjakovës, duke ditur se pushtuesi fashist dhe bashkëpunëtorët e tij do të organizonin kremtimin e 30 vjetorit të shpalljes së pavarësisë shqiptare si dhe qëllimin e këtyre manifestimeve, ju kundërvua atyre, duke marrë vendim që më 28 nëndor të organizohen demonstratat antifashiste.

Në gazetën »Tomori« të datës 26 nëndor 1942 pushtuesi dhe qeveria kukëll kishin shpallur programin e kremtimit të 28 nëndorit:

1. Flamuri kombëtar të ngrihet në të gjitha ndërtesat botore dhe private;
2. Të zhvillohen ceremonitë fetare ndër fshatra;
3. Pritje ndër selitë e prefekturave dhe nënprefekturave;
4. Çfaqje sportive.<sup>20</sup>

Për t'i sabotuar manifestimet fashiste, Komiteti lokal i PKJ, më 26 nëndor 1942, mbajti një mbledhje. Pas mbledhjes, komunistët e rinj u angazhuan që më 27 nëndor të shpërndanin nëpër qy-

<sup>19</sup> Si shën. 3, f. 370.

<sup>20</sup> Po aty, f. 373.

tet proklamata që flisnin mbi të vërtetën e Lëvizjes NÇ dhe mbi çështjen e »shlirimit« të shqiptarëve nga ana e pushtuesit fashist.

Më 27 nëndor Këshilli nacionalçlirimtar, që tani më ishte stabilizuar mirë dhe kontribonte mjaft në zgjerimin e Lëvizjes shpall një proklamata drejtuar shqiptarëve të kësaj ane me rastin e 30 vjetorit të festës së flamurit shqiptar. Në këtë proklamata mbasi flitet për shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë, theksohej se populli i Kosovës mbeti në sundimin e qeverisë reacionare dhe jo populllore të mbretërisë së Jugosllavisë, duke hequr të gjitha të zezat më tepër se 23 vite. Në proklamata thuhej me të drejtë se edhe shqiptarët e kësaj ane, sikurse edhe popujt e Jugosllavisë, ishin robëruar nga forcat fashiste, prandaj garanca e shlirimit nga fashizmi janë njësitë partizane, të cilat u formuan në Kosovë.<sup>21</sup> Në fund të kësaj proklamate thuhej se KNÇ i Gjakovës, Rekës dhe Podrimës i thërret shqiptarët e kësaj ane që të formojnë aradha partizane dhe KNÇ si garanci për fitimin e lirisë dhe të drejtës për vetëvendosje.<sup>22</sup>

Për të grumbulluar sa më tepër të rinj në demonstrata, më 27 nëndor u organizua mbledhja e komunistëve të rinj, në të cilën muar pjesë edhe Ymer Pula. Këtu u vendos që në mbrëmje të 27 nëndorit, rinia të dalë me baklada në rrugët e qytetit dhe, duke kënduar këngë revolucionare e kombëtare, të agjitojë te rinia antifashiste për të marrë pjesë në demonstratat e 28 nëndorit.

Në ditën e 28 nëndorit komunistët, komunistët e rinj dhe rinia antifashiste u tubuan në shkollën fillore »Bajram Curri«. Këtu demonstruesve u foli Xhevdet Hamza, i cili në këtë kohë ishte ilegal. Ai në mes të tjerash theksoi nevojën e zhvillimit të luftës së armatosur kundër pushtuesve dhe domosdoshmërinë e bashkimit të masave në luftë të përbashkët për të fituar lirinë e vërtetë.

Gjatë demonstratës, demonstruesit brohoritnin këto parulla: »Jashtë okupatori!«, »Poshtë fashizmi!«, »Të gjithë kundër okupatorit!«, »Rroftë bashkimi dhe vëllazërimi në mes të shqiptarëve dhe serbëve e malazezëve!«.<sup>23</sup>

Pasditën e 28 nëndorit 1942 nga të rinjtë komunistë u organizua një çfaqje antifashiste në kafenenë »Romë—Berlin« të Hysen Batushës, me të hollat që i kishin mbledhur në popull.<sup>24</sup>

Nga kjo kafene u dërgua një grup në rrugën e serbëve për t'i ftuar që të marrin pjesë në këtë tubim; prej tyre erdhën Dragoljub Gligorijeviq, Stanoje Stanojeviq dhe Aleksandër Vasiq.

Gjatë qëndrimit në kafene të rinjtë kënduan këngë revolucionare dhe hodhën parulla antifashiste: »Poshtë Duçja!«, »Poshtë Hitleri!«, »Poshtë fashizmi!«, »Rroftë Stalini!«, »Rroftë Bashkimi sovjetik!«, »Rroftë LNÇ!«.<sup>25</sup> Pjesëmarrësve, të kësaj gostie, që ishin nja 100 veta, u mbajtën fjalime, që theksonin se pushtuesi fashist ka për qëllim që ta përçajë popullin shqiptar me atë serb e malazez dhe se vetëm të bashkuar mund të fitohet liria e vërtetë.

<sup>21</sup> Po aty.

<sup>22</sup> Po aty.

<sup>23</sup> Po aty.

<sup>24</sup> U mbledh një shumë prej 500 napoleonash për organizimin e çfaqjes.

<sup>25</sup> Si shën. 3, f. 374.

Në këtë tubim të rinjtë vendosën të shkojnë në kafenenë »Savoja«, ku fashistët dhe pjesëtarët e pushtetit kuizling ishin tubuar për të festuar 30 vjetorin e pavarësisë së Shqipërisë. Aty ishte organizuar edhe një çfaqje teatrale.

Grupi i të rinjve komunistë prej 15 vetësh u përpoq të hyjë në këtë kafene, por u pengua nga roja fashiste. Pasi atë e larguan me forcë, i thyen dyert e kafenesë dhe hynë mbrënda. I pari që hyri mbrënda brohoriti »Rroftë Partia komuniste« dhe »Poshtë fashizmi«. Pas tij hynë edhe të rinjtë tjerë dhe u krijua një tollovi. Ndër kohë udhëheqësi i këtij grupi të rinjsh, Mazllom Shunjaku mbajti një fjalim kundër fashizmit dhe terrorit si dhe mbi luftën për liri. Në sy të fashistëve u shkye flamuri shqiptar me shenjën e lektorit dhe u ngrit flamuri i vërtetë shqiptar. Fashistët dhe bashkëpunëtorët e tyre mbetën të habitur e të frikësuar e nuk ndërmuarën asgjë në atë moment. Çfaqja fashiste u sabotua dhe të rinjtë komunistë u shpërndanë nëpër shtëpitë e tyre.

Gjatë demonstratës, organizimit të çfaqjes në kafenenë »Romë — Berlin« dhe sabotimit të çfaqjes fashiste në kafenenë e madhe, grupi i të rinjve u përcuall nga ana e karabinierisë dhe bashkëpunëtorëve të saj, me ç'rast u identifikuan pjesëtarët më të dalluar të demonstratës dhe të tubimit në kafene. Të nesërmën, më 29 nëndor, të rinjtë që kishin marrë pjesë në demonstrata dhe në sabotimin e çfaqjes fashiste, u informuan se karabinieria i kërkonte për t'i burgosur sipas listës, që mbërthente 22 demonstrues.<sup>26</sup>

Nga karabinieria u arrestuan: Halil Meta, Mazllom Shunjaku e Skender Xharra. Të tjerët kaluan në aradhat partizane ose mbetën në qytet si ilegalë. Të burgosurit u torturuan në burg. Në burgun hetues ata mbetën 15 ditë e pastaj i vendosën në burgun kryesor të qytetit, që gjendej në Rrugën e serbëve, ku mbetën gjer në kapitullimin e Italisë fashiste.

Për këto demonstrata bën fjalë një shkresë e prefekturës së Prizrenit, e cila mban datën 5 dhjetor 1942, që ia dërgoi Ministrisë së punëve të brëndshme të Shqipërisë. Në këtë shkresë, në mes tjerash, thuhet: »Në demonstrata të bëra gjatë ditës janë dëgjuar zërat: »Poshtë Italia e Gjermania!«.<sup>27</sup>

Në këtë dokument përmendet se organizator i dalluar i demonstratave ishte Xhevdet Hamza.<sup>28</sup>

Po në këtë dokument bëhet fjalë edhe për ngjarjet në kafenenë »Romë—Berlin« dhe kafenenë »Savoja«, ku thuhet: »Në sallë hyri një grumbull djelmësh, më së shumti zejtarë, të cilët vinin nga kafehanja »Romë—Berlin« dhe njëri nga të rinjtë e ka sharë Duçen«. Dokumenti përmend edhe emrat e të burgosurëve më 29 nëndor të vitit 1942: Halil Bush Meta, Mazllom Shaban Shunjaku dhe Skender Iliaz Xharra.<sup>29</sup>

<sup>26</sup> Xheladin Nixha, Metush Grezda, Halil Meta, Jusuf Zherka, Etëhem Spahi, Mazllom Cana, Mazllom Baraku, Mazllom Shunjaku, Skender Xharra, Sani Hoxha, Stanoje Stanojeviqi, Musa Zajmi, Abedin Terbeshi, Cen Dautaga, Xhevdet Pula, Cen Zherka, Sahit Shasivari, Met Gunga, Rexhep Dobruna, Nuredin Tullumbi, Remzi Pula dhe Ferat Binishi.

<sup>27</sup> Si shën. 3.

<sup>28</sup> Po aty.

<sup>29</sup> Po aty.

Këto demonstrata, si edhe ajo 28 nëndorit të vitit 1941, kontribuan në përhapjen dhe pjesëmarrjen e masave të gjera punonjëse shqiptare në Lëvizjen nacionalçlirimtare, si dhe në forcimin e vëllëzërimit dhe të bashkimit të shqiptarëve, sërbëve dhe malazezëve. Kjo demonstratë dhe ngjarjet në kafenenë »Romë—Berlin« si dhe sabotimi i çfaqjes teatrale në kafenën »Savoja« tronditën thellë pushtuesin dhe pushtetin kuisling.

### Demonstratat e shkurtit të vitit 1943

Si demonstratat e mëparshme, edhe këto i organizoi Komiteti lokal i PKJ. Demonstratat filluan së pari në Prizren, më 17 shkurt 1943, e pastaj plasën edhe në qytetin e Gjakovës.

Mendimin për organizimin e demonstratave të shkurtit e dhanë Boris Vukmiroviqi dhe Ramiz Sadiku, që atëherë gjëndeshin në Gjakovë. Këta udhëheqës të Komitetit krahinor kërkuan nga sekretari i Komitetit lokal Ymer Pula që të mbajë një mbledhje dhe të merret vendimi për organizimin e demonstratave antifashiste.<sup>30</sup>

Mbledhja u mbajt më 17 shkurt, ku u muar vendimi dhe u caktuan parullat: »Poshtë terrori!«, »Jashtë pushtuesi!«, »Rroftë liria!«, »Kërkojmë lirinë e të burgosurëve!«.<sup>31</sup>

Për përfshirjen sa më të gjërë në demonstrata, Komiteti lokal, angazhoi KNÇ, që ishte shumë aktiv dhe Komitetin lokal të SKOJ-it.

Përveç komunistëve të rinj, në demonstratë morën pjesë në mënyrë masive edhe rinia antifashiste dhe pionierët.

Për t'u përfshirë edhe shtresa e fshatarëve, u caktua që demonstratat të mbahen ditën e pazarit.

KNÇ informoi të gjithë dyqanxhinjtë, që ishin simpatizues të Lëvizjes, t'i mbyllin dyqanet dhe në momentin kur demonstruesit do të kalojnë anej, t'u bashkohen atyre.

Sjelljet e rrepta dhe terrori që kishin përdorur pushtuesi me bashkëpunëtorët e tij ndaj popullit pas aksionit të Aradhës partizane »Emin Duraku«, në rrugën në mes të Pejës dhe Gjakovës, afër fshatit Rastavicë (burgosja e Demush Gjakovës, Cajë Dautagës dhe Rremë Rudit) shkaktuan në popull pezmatim të madh. Me burgosjen e Demush Gjakovës, i cili ishte mësues dhe kryetar i KNÇ, i dëshpëroi mësuesit e këtij qyteti. E gjithë kjo ndikoi në përfshirjen masive në demonstratë.<sup>32</sup>

Në mbrëmje të 17 shkurtit të vitit 1943 të rinjtë dhe pionierët shpërndanë nëpër shtëpia dhe nëpër rrugë proklamatat e Komitetit lokal të PKJ. Të nesërmen, në mëngjez, demonstruesit u mbledhën te Hani i Haraçisë dhe në orën 9 u nisën në drejtim të Qarshisë së Madhe. Gjatë rrugës brohoritnin parrullat e përmendura

<sup>30</sup> Ali Hadri, *LNÇ e Gjakovës*, 10/1958, f. 681.

<sup>31</sup> Si shën. 3, f. 376.

<sup>32</sup> Qamil Gexha, *KNÇ i Gjakovës, PKJ dhe pushteti revolucionar në Kosovë*, Prishtinë, 1971.

dhe kërkonin lirim nga burgju të anëtarëve të KNÇ. Te Banka e vjetër, karabinieria vetëm i përcolli me armë dhe nuk përdori forcën.<sup>33</sup>

Gjatë rrugës demonstruesve u bashkoheshin tregëtarët, zejtarët dhe një pjesë e fshatarëve. Pasi kaluan Qarshinë e Madhe dhe erdhën te Shkolla Normale, atyre iu bashkua edhe rinia e kësaj shkolle, e cila u dha gjallëri edhe më të madhe demonstratave. Demonstruesit vazhduan rrugën në drejtim të Bashkisë e prej këndeje në drejtim të Nënprefekturës te Fushat e Bajram Pashës (sot qendra e qytetit). Këtu numri i demonstruesve arriti në 3000 vetë. Nënprefektura ishte e mbrojtur me karabinierë dhe me ushtarë. Mareshali i karabinierisë u doli përpara demonstruesve dhe i pyeti se ç'kërkonin. Sami Peja u përgjegj në italishte se kërkonin nga burgju Demush Gjakovën, Cajë Dautagën dhe Muharrem Rudin. Mareshalli dha premtimin se ka për t'i liruar ata, me kusht që demonstruesit të shpërndahen. Këta nuk pranuan dhe Jusuf Zherka, që ishte në ballë të demonstratave me Xajë Golën, që mbante flamurin, bërtiti »Sparare, shtini në ne, o gjakatarë«.<sup>34</sup>

Pastaj demonstruesit vazhduan rrugën në drejtim të Varrezave të Qerimit, më qëllim që të shkojnë te burgju për të kërkuar me çdo kusht lirim e të burgosurëve. Mirëpo, pushtuesi para burgut kishte bërë përforcime edhe me një kompani alpinistësh. Demonstruesit, duke e parë këtë gjendje, vazhduan rrugën. Prapa demonstruesve shtohet numri i karabinierëve dhe i alpinistëve. Te varrezat e kësaj lagje u bë një ndeshje me armë. Pjesa më e madhe e demonstruesve, që nuk ishin të armatosur, u tërhoqën në drejtim të Çabratit, ndërsa rreth 20 komunistë të armatosur u ndalën te teqja e Haxhi sheh Musas për t'i mbrojtur demonstruesit nga fashistët, gjersa të tërhiqeshin. Komunistë të armatosur ishin Zenel Zherka, Musa Rexhepi, Xheladin Spahiu, Etëhem Spahiu, Jusuf Zherka etj. Zenel Zherka i gjuajti dy bombe dore. Alpinistët dhe karabinierët u shtrinë për tokë, e pastaj filluan të shtirat nga të dy anët, me ç'rast u vra Zija Hamalli. Pak më vonë edhe komunistët u tërhoqën. Të shtirat kundër demonstruesve vazhduan edhe më tutje, e u vra i riu Shani Nushi.

Për shkak se pjesëmarrja dhe rezistenca e demonstruesve ishte më e madhe në lagjet rreth Çabratit, karabinieria hyri në shtëpitë e këtyre lagjeve dhe filloi represaliet në masë të gjërë. Ata, në të cilët dyshuan se kanë marrë pjesë në demonstrata, i burgosën. Numri i të burgosurëve arriti gjer në 200 vetë, të cilët i torturuan. Prej këtyre të burgosurëve, më të dyshimtët i dërguan në kampin e përqëndrimit në »Porto Romano«.<sup>35</sup>

Dy ditë pas shuarjes së demonstratave, Komiteti lokal shtypi dhe shpërndau një komunikatë në të cilën qytetarëve të Gjakovës u drejtohej me këto fjalë: »Barbarët fashistë pambramë e kanë terrorizue popullin e qytetit të Gjakovës. Nga vendet e ndryshme kanë pru milicë e karabinierë hajdutë, e tue i vendue mitrolozat

<sup>33</sup> Po aty.

<sup>34</sup> Si shën. 3, f. 337.

<sup>35</sup> Si shën. 32.

nëpër rruga kanë fillue veprimin e tyre të ndyet. Hajdutëve fashistë nuk iu ka mjaftue këjo, por filluen të hyjnë në shtëpitë e qytetarëve të qetë duke u cenuar nderin familjeve të tyre dhe duke i burgosur. Prej dorës së tyre gjakatare ra viktimë një mullis. Në mes të arrestuarve ndodhet edhe inspektori i arësimit, i cili është torturua nga fashistët barbarë.<sup>36</sup> Pastaj në këtë komunikatë flitet për masakrat dhe rrahjet e arrestimet në Prizren. Më tutje tregohet se fashizmi këto gjëra është duke i zbatuar para kapitulimit të tij për ta trembur popullin, por llogaria e tyre është shumë e gabuar, sepse shqiptarët, sërbët dhe malazezët e ndershëm e kanë kuptuar se armiku i përbashkët i tyre është vetëm pushtuesi fashistë bashkë me bashkëpunëtorët e tij, prandaj ata do ta vazhdojnë luftën edhe më të rrepët kundër pushtuesit gjer në vdekjen e fashizmit dhe në lirinë e popullit.<sup>37</sup>

Mita Milkoviqi, anëtar i Komitetit krahinor të PKJ, në një artikull të fletores »Kroz borbu«, duke folur për demonstratat e shkurtit të vitit 1943 në Prizren, Gjakovë dhe Prishtinë thotë se ngjarjet kanë ndikuar jo vetëm në masat shqiptare, por edhe ndër sërbë dhe malazezë në Kosovë dhe kanë treguar se populli shqiptar nuk është fajtor për mjerimin e popullit serb dhe malazez. Pastaj thotë se këto demonstrata kanë rëndësi edhe nga aspekti i zhvillimit të frymës së vëllazërimit dhe të bashkimit në mes të popujve të Kosovës dhe se ato e tronditën aqë shumë pushtuesin dhe pushtetin kuisling sa që edhe organet më të larta të »Shqipërisë së Madhe« i marrin në shqyrtim dhe propozojnë masa të drepta ndëshkuese.<sup>38</sup>

### **Përfundim**

Demonstratat e përmendura më lartë, të organizuara nga komunistët, patën ndikim dhe jehonë të madhe jo vetëm në popullin e Gjakovës, por edhe në mbarë Kosovën. Këto ngjarje dëshmojnë më së miri për forcën e Lëvizjes. Është e rëndësishme edhe përfshirja e fshatarësisë në demonstrata, e veçanërisht në ato të shkurtit të vitit 1943.

Demonstratat antifashiste ndikuan dukshëm në rritjen e frymës luftarake të popullit, e veçanërisht të rinisë antifashiste.

Këto demonstrata zënë një vend të rëndësishëm në historinë e LNÇ edhe nga shkakut se e tronditën pushtetin dhe demagogjinë e pushtuesit fashist.

<sup>36</sup> AEHK, d. 1969.

<sup>37</sup> Po aty.

<sup>38</sup> Si shën. 3, f. 379.

Qamil Gexha

MANIFESTATIONS ANTIFASCISTES A GJAKOVË PENDANT  
LE MOUVEMENT DE LIBERATION NATIONALE

Résumé

Le présent travail concerne les manifestations antifascistes de Gjakovë pendant la Deuxième guerre mondiale.

Au début on aborde les manifestations antifascistes du 28 novembre 1941, et ensuite on parle des manifestations antifascistes du 28 novembre 1942 et finalement de celles du février 1943.

Les manifestations mentionnées ci-dessus, organisées par des communistes, eurent une grande influence et un écho particulier non seulement dans la population de Gjakovë, mais aussi dans le Kossovo tout entier. Ces événements -là témoignent, de manière évidente, de la force et de la portée du Mouvement en question. Il est à noter comme fait important la participation des paysans aux manifestations et en particulier leur participation aux manifestations du février de 1943.

Les manifestations antifascistes influencèrent, pour une large part, l'éveil de l'esprit belliqueux du peuple et particulièrement de la jeunesse antifasciste.

Ces manifestations occupent une place de grande importance dans l'histoire de la Guerre de libération nationale aussi du fait qu'elles ébranlèrent le régime et la démagogie de l'occupant fasciste.